



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 239/10 Prot

Tiranë më 30.06. 2015

V E N D I M

Nr. 61, datë 30 / 06 / 2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institutin e Zhvillimit të Arsimit

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Institutin e Zhvillimit të Arsimit,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 30, datë 23.03.2015 "Për një shtesë në vendimin nr. 14, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", vendosa kryesisht fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i mbikëqyrjes ishte i përgjithshëm dhe përfshinte monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua në periudhën 24.03.2015 deri 27.03.2015, sipas programit të mbikëqyrjes nr. 239/2 prot., datë 11.03.2015, njoftuar institucionit me shkresën nr. 274/1 prot., datë 23.03.2015, "Dërgohet vendimi i ndërmjetëm për një shtesë në vendimin nr. 14, datë 11.03.2015".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i inspektimit hartoi projektraportin, dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 239/6 prot., datë 25.05.2015, "Dërgohet projektraporti", duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Në vijim të procesit, me shkresën nr. 239/9, datë 29.05.2015, "*Kthim projektraporti*", Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka kthyer pranë Komisionerit projektraportin e nënshkruar nga titullari i institucionit, së bashku me observacionet përkatëse në lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes, si dhe aktet administrative që i mbështesin ato.

Pasi analizova përmbajtjen e këtyre akteve dhe pasi i krahasova me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, në përfundim vlerësoj se nga ana e institucionit është reaguar në lidhje me disa parregullsi të evidentuara gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Konkretisht, këto raste kanë të bëjnë me nxjerrjen e akteve administrative nominale, për të finalizuar periudhën e provës, për punonjësit e kategorizuar në këtë grup, si dhe me marrjen e masave për të materializuar korrespondencën me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në lidhje me marrjen e miratimit për shtyrjen e periudhës së punësimit, e për pasojë shtyrjen e periudhës së shpalljes së pozicionit si të lirë, për dy punonjës që dalin në pension gjatë vitit 2015. Këto aspekte janë analizuar në mënyrë të detajuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, duke i shoqëruar me argumentat përkatës, sipas rastit të trajtuar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A :

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore dhe për të evituar subjektivizmin në nivelin e vlerësimit.
3. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e përshkrimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore, për të mundësuar verifikimin dhe

administrimin e formularit të përshkrimit të punës nga Departamenti i Administratës Publike.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Për këtë vendim të njoftohet Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA